

# AKT THEMELIMI PËR SHOQËRINË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “ATV TIRANA” SH.P.K.

## KAPITULLI I.

### THEMELIMI, EMRI DHE THEMELUESIT

#### Neni 1

##### Themelimi, Forma dhe Ortakët

Sot me datë 03.07.2024 ne themeluesit kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “ATV TIRANA” SH.P.K.

Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Sokrat Sadiku**, shtetas shqiptar, lindur në Karic, në 25.06.1977, mbajtës i kartës së identitetit nr. H70625074I.
- **Ariola Vuka**, shtetase shqiptare, lindur ne Burrel, në 24.10.1991, mbajtese e kartes se identitetit nr. J16024050Q.
- **Gazment Sadiku**, shtetas shqiptar, lindur në Karicë, në 19.09.1976, mbajtes i kartes se identitetit nr. H60919063R.
- **Kel Sadiku**, shtetas shqiptar, lindur ne Burrel, në 03.02.1981, mbajtes i kartes se identitetit nr. I10203075E.

#### Neni 2

##### Objekti

##### Shoqëria do te kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Dhënia me qira dhe shit-blerje të motorëve specialë ATV/QUAD Bike, të makinave dhe të bicikletave.

Aktivitete Turistike dhe Aventura në Natyrë: Menaxhimi i udhëtimeve të aventurës në natyrë, përfshirë ture të specializuara me motor dhe sporte të tjera adventureske.

Importi dhe eksporti i pajisjeve dhe aksesorëve të nevojshëm.

Kompania lejohet të ndjekë të gjitha aktivitetet ligjore të biznesit për të mbështetur misionin e saj dhe të bashkëpunojë me firma të ngjashme.

### **Neni 3**

#### **Objekti i Shoqërisë**

Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të Shoqërisë.

### **Neni 4**

#### **Selia.**

**4.1** Selia e Shoqërisë është Yzberish, Tirane, numri i pasurise 312/97, zona kadastrale nr. 3866, njesia administrative nr.14.

**4.2** Transferimi i Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

**4.3** Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si dhe jashtë saj.

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja e veprimtarisë.**

**5.1** Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë për një periudhe të pakufizuar.

**5.2** Shoqëria mund të prishet në çdo kohë me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve.

## **KAPITULLI II**

### **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TE KAPITALIT.**

### **Neni 6**

#### **Kapitali themeltar.**

**6.1** Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

**6.2** Pjesemarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaket themelues jane:

- **Sokrat Sadiku**, zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 70.000 (shtatedhjete mijë) leke që përben 70% të kapitalit themeltar të shoqërisë.



- **Kel Sadiku**, zoterues i nje kuote me vlore te perjithshme 10.000 (dhjete mijë) leke qe perben 10% te kapitalit themeltar te shoqerise.
- **Ariola Vuka**, zoteruese e 1 (nje) kuote me vlore te perjithshme 10.000 (dhjete mijë) leke qe perben 10% te kapitalit themeltar te shoqerise.
- **Gazment Sadiku**, zoterues 1(nje) kuote me vlore te perjithshme 10.000 (dhjete mijë) leke qe perben 10% te kapitalit themeltar te shoqerise.

## Neni 7

### **Derdhja Kapitalit**

Derdhja e kapitalit do te kryhet pas rregjistrimit te Shoqerise ne rregjistrin tregtar, gjate fazes se zhvillimit te aktivitetit te Shoqerise.

## Neni 8.

### **Rritja e kapitalit themeltar.**

8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve që përfaqësojnë % e kapitalit të shoqërisë.

8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, kuotat e ortakëve të shoqërisë do të rriten sipas shumave të përcaktuara në vendimin e asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

### **Neni 9- Zvogëlimi i kapitalit themeltar.**

9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuara nga ligji.

9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve sipas shumave të përcaktuara në vendimin e asamblesë.

### **Neni 10- Transferimi i kuotave të kapitalit dhe e drejta e parablerjes.**

10.1. Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve sipas nenit 73 të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

10.2 Në rast transferimi të kuotave të kapitalit në çdo lloj forme personave të tretë, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim, me çdo kusht, duke përfshirë edhe dhurimin e kuotave, ortakët e tjerë gjëzojnë të drejtën e parablerjes mbi këto kuota kapitali.

## KAPITULLI III

### ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABËL.

#### Neni 11

##### Asambleja e ortakëve.

11.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

11.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i pjesëve të kapitalit që zotëron.

11.3 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anë të së cilës mund të japë votën e tij.

11.4 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, nëqoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

11.5 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve ose nga një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Në çdo rast, Asambleja thirret të paktën një herë në vit, jo më vonë së fundi i muajit të Qershorit për të diskutuar, vlerësuar dhe miratuar bilancin e vitit të fundit financiar.

11.6 Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njofimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakeve të paktën 7 (shtatë) ditë përpresa mbledhjes së Asamblese. Thirrja duhet të mbaj informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat duhet të merret vendimi mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së pare dhe të dtë.

11.7 Asambleja do të quhet rregullisht e mbledhur edhe nëse formalitetet e thirrjes nuk respektohen, nëse ortakët që përfaqësojnë kapitalin e plotë janë të pranishem apo te perfaqesuar dhe janë dakord te mbajne mbledhjen edhe formalitetet e lartpërmendura nuk janë respektuar.

11.8 Cdo Asamble drejtohet nga Kryetari i emëruar ndërmjet ortakëve ose personave të tretë. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo ortak, nëse prania e noterit nuk është e nevojshme.

11.9 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj. Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet



telekonferencës dhe video konferencës , me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe ti lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të argumenteve; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

## Neni 12

### Kuorumi dhe kompetencat e Asamblesë.

12.1 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, të cilat merren me shumicë të zakonshme, janë të vlefshme nëse janë të pranishem ortakë me të drejtë vote që përfaqësojnë me shumë se 51% të kapitalit. Në rast mungese të këtij kuorumi në mbledhjen e parë, Asambleja thirret në mbledhjen e dytë me të njëtin rend dite jo më vonë se 7 (shtatë) dite pas mbledhjes së parë.

Asambleja e Zakonshme merr vendime me shumicën e thjeshtë të ortakeve të pranishëm të përfaqësuar.

12.2 Vendimet e Asamblesë Përgjithshme, të cilat merren me shumicë të kualifikuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që përfaqësojnë më shumë se 71% të kapitalit. Në rast mungese të këtij kuorumi në mbledhjen e parë Asambleja thirret në mbledhjen e dytë me të njëtin rend dite jo më vonë se 7(shtatë) ditë pas mbledhjes së parë. Asambleja e Jashtëzakonshme merr vendime me shumicën e kualifikuar % të ortakëve të pranishëm apo të përfaqësuar.

12.3 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të kualifikuar % të ortakëve të pranishëm për ndryshimet e statutit, rritjen apo zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shkrirjen e shoqërisë dhe të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj nga ky statut.

## Neni 13- Administrimi.

13.1 Shoqëria administrohet nga 1(Një) Administratorë i cili qëndron në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen, për një periudhë prej 5(pesë)vjet me të drejtë rizgjedhjeje nga Asambleja për të njëjtën periudhë.

13.2 Administratori/ët mund të ndërmarrin të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshem te shoqërisë, me përjashtim të atyre që ju rezervohen organeve të tjera të shoqërisë nga ky statut apo ligji i zbatueshëm

Handwritten signatures of the members of the Assembly, including initials and names, are visible along the bottom left edge of the page.

13.3 Përfaqesimi ligjor i Shoqërisë i përket Administratorit/ve të cilët janë:  
**Z.Sokrat Sadiku, shtetas shqiptar, lindur më 25.06.1977 e me banim në Karic, Shqipëri, madhor dhe me zotesi per te vepruar, me ID nr. H70625074I.**

13.4 Admmistratori/ët mund të emërojë/në përfaqësues të posçëm për akte të veçanta ose për kategori aktesh.

#### **Neni 14-Eksperti kontabël i autorizuar.**

14.1 Në rast se përcaktohet nga ligji apo kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar.

14.2 Eksperti kontabël i autorizuar do të emërohet për 1(një) vit ushtrimor financiar dhe do të mbarojë mandatin e tij në datën e asamblesë së mbledhur për miratimin e bilancit të vitit të kaluar ushtrimor, me të drejtë rizgjedhje.

14.3 Eksperti kontabël i miratuar mund të revokohet sipas normave të legjislacionit në fuqi.

### KAPITULLI IV

#### VITI FINANCIAR ,BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

#### **Neni 15**

##### **Viti finanziar dhe bilanci vjetor.**

15.1 Viti finanziar fillon më 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të secilit vit.

15.2 Viti i parë ushtrimor fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise prane Oëndrës Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon në 31 dhjetor të atij viti.

15.3 Bilanci vjetor, inventari, relacioni i Administratorit/ve dhe eventualisht i ekspertit kontabël (nëse është emëruar) do të miratohen nga Asambleja sipas shumicës së përcaktuar në ligjin 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërите Tregtare".

15.4 Miratimi i dokumenteve që kanë të bëjnë me vitin ushtrimor do të bëhet brenda 6 muajve nga data e mbarimit të vitit ushtrimor.

#### **Neni 16**

##### **Fitimet.**

16.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci duke zbritur 5%(pesëpërqind) për rezerva ligjore deri në arritjen 10%(dhjetë përqind) të kapitalit si dhe shumat



e tjera që mund të lënë menjanë Asambleja me vendim, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.

16.2 Asambleja mund të vodosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo edhe shtyrjen e shpërndaries se Fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet e tjera financiare.

## KAPITULLI V

### SHPERNDARJA DHE LIKUDIMII SHOQERISE

#### Neni 17

##### Prishja.

17.1 Shoqëria prishet me perfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e paparashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.

17.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes ose falimentimit të ortakëve.

#### Neni 18

##### Likuidimi.

18.1 Në rast prishjeje, Shoqëria duhet të likuidohet.

18.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjëndjen e aktivit dhe pasivit të bilancit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

18.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit Asambleja do të vodosë mbi bilancin financier përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

18.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit të ortakëve, në proporcion me kuotat e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

#### Neni 19

##### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

19.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis palëve që mund të lindin ose lidhen me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti dhe Akti të Themellmit si dhe



në përgjithësi çdo mosmarrëveshje që mund të lind mes ortakeve (përveç mosmarrëveshjeve që kane të bëjnë me raporte personale dhe nuk lidhen me shoqërinë), ose midis disa ortakëve me shoqerinë do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve me diskutim të drejtpërdrejtë të të interesuarve 19.2 Nëse nuk arrihet që një mosmarrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

#### Neni 20- Gjuha.

20.1 Ky statut nënshkruhet në 2(dy) kopje në gjuhën shqipe.

### ORTAKËT E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “ATV TIRANA” SH.P.K.

**Sokrat Sadiku**  
Sokrat Sadiku 

**Ariola Vuka**  
Ariola Vuka

**Kel Sadiku**  
Kel Sadiku 

**Gazment Sadiku**  
Gazment Sadiku  
